



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo / Republic of Kosovo  
Komuna e Rahovecit  
Opština Orahovac/Municipality of Rahovec  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport



Nr.13. Zyrtar -2022  
Dt. 07.11.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC  
Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport  
Odeljenje za Kulturu, Omladinu i Sport

-XIII- Nr. I prot. 147 Br. prot. Më Dt. 07.11.2022  
RAHOVEC - ORAHOVAC

Bazuar në vendimin nr.1427 të datës 30.04.2019 të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, për themelimin e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi” dhe ne bazë të rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve të aprovuar në Kuvendin Komunal – Rahovec me datë 31.05.2022 me Nr.Prot.327, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

## KONKURS PËR KRIJIMTARI LETRARE (Për të rritur)

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Rahovecit, me synim të nxitjes së krijimtarisë letrare-artistike, fton krijuesit letrar nga të gjitha treva shqiptare që të konkurrojnë me punimet e tyre letrare – artistike për çmimin letrar vjetor “Sulejman Krasniqi”, që ndahet në kuadër të shënimit të Ditës së Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi”.

Vlerësimi bëhet nga njohës të fushës, ( juria profesionale), që formohet nga organet drejtuese të Komunës së Rahovecit.

◆ Fituesit e çmimit letrar “Sulejman Krasniqi” shpërblehen me shuma të caktuara monetare, ndërsa rezultatet e konkursit publikohen më 7 dhjetor 2022, me rastin e Ditës së Bibliotekës Komunale “Sulejman Krasniqi” në Rahovec.

◆ Konkursi ka për qëllim që të nxisë krijuesit që të merren me poezi dhe krijimtari letrare në prozë.

- ☐ Krijimi letrar (prozë apo poezi) nuk preferohet të jetë më i gjatë se 4 faqe A4.
- ☐ Punimet dorëzohen në kopje fizike (tri kopje) në zarf të mbyllur dhe me shifër (kod).
- ☐ Afati për dorëzimin e punimeve do të jetë nga 07 nëntor 2022 deri më 01 dhjetor 2022.
- ☐ Përshkrimi: Për Çmimin letrar “Sulejman Krasniqi”.
- ☐ Adresa: Komuna e Rahovecit Rr. Dëshmorët e Pashtrikut p.n, sporteli Nr. 7

Rahovec, 7 nëntor 2022



Drejtori i DKRS-së

Afrim Dina